



Address: Qendra Zejtare 64/B, Peja, Kosova
Tel: +377 (0)44 111 408
+377 (0)44 142 895
Email: vizionipe@hotmail.com
<http://come.to/vizionit>
MEB Bank - Peja – Account No. 30085368

Mendo Globalisht Vepro Lokalisht

ORGANIZATA JO QEVERITARE "SYRI I VIZIONIT"

RAPORTI VJETOR 2001

Përmbajtja:

- Organizimi i Brendshëm & Aspektet e Menaxhimit
- Projektet kryesore të zhvilluara gjatë vitit 2001
- Raportet Financiare
- Prespektivat për vitin 2002

Organizata Jo Qeveritare "Syri i Vizionit" (SiV)

Numri i Regjistrimit (në OKB) OJQ-së: 510144-2

Data e Regjistrimit: 17 Shtator 2001

Adresa: Qendra Zejtare 64/B Pejë

Email: vizionipe@hotmail.com

Personi kontaktues: Veton Mujaj, Pejë, Drejtor i Organizatës

Informatat mbi Organizatën Jo Qeveritare "SiV"

Organizata Jo Qeveritare "Syri i Vizionit"

Si rrjedhojë e punës së vazhdueshme të revistës të rinjve "Vizioni" që filloi si një iniciativë e disa nga të rinjtë entuziast të Pejës për më shumë se një vit, për të rrethuar afër vetes rreth katërdhjetë të rinj nga mbarë Kosova dhe jashtë saj, me ndihmën 12 mujore nga USAID-KTI Pejë, ka filluar të vëren rezultatet e punës së madhe të kryer gjatë kësaj periudhe kohore.

Interesimi që rinia filloi të shpreh për një revistë të këtij lloji, bëri që njerëzit e kyçur në mënyrë direkte apo indirekte të punojnë pandalur për të sjellur para lexuesit informacione, gjithmonë me kohë, të vërteta, të bazuara në fakte, transparente në problemet rinore, barazi gjinore, demokraci, avokim, të drejtat e njeriut, pengesat jetësore, arsimim, aktivitete, vizione, ambient, shoqëri të hapur, etj.

Besojmë se objektivat e vendosura para vetes, janë arritur në një mënyrë të befasueshme. Gazetar të ri, të talentuar janë zhvilluar, të cilët dolën në sipërfaqe nëpërmes amgazhimit të tyre vullnetar në revistë. Vetëdijesimi në gjërat me interes të përbashkët, i cili ishte njëri ndër qëllimet tona kryesore, është ngritur në një nivel që nuk ka qenë ndonjëherë më parë.

Qëllime dhe shqyrtime të shkurta mbi historinë e organizatës

Qëllimet e personelit dhe organizatës kanë qenë dhe mbetin arritja e:

- Një gjenerate të re gazetarësh
- Krijimit të një rinie demokratike dhe tolerante
- Bashkimit të ideve të të rinjve dhe kalimi i pengesave, pa dallim kombësie, race apo besimi
- Përmirësimit të kushteve të jetesës të rinjve nëpërmes vet-angazhimit
- Vetëdijesimit më të madh në; kulturë, art, ambient, sport dhe sfera tjera jetësore
- Qasjes më meritorë në çështjen e gruas në shoqërinë tonë
- Inkurajimit të rinisë që të marrin rol më aktiv në institucionet publike
- Vetëdijesimit të mëtutjeshëm në teknologjinë e re dhe ekonomi
- Përfshirja e shumë aktiviteteve të reja për rininë që në të ardhmen do të mundësojnë vetmbajtjen e organizatës.

A) Informata për strukturën udhëheqëse dhe personelin

Struktura udhëheqëse janë të moshës 26-27 vjeqare, ndërsa personeli përbëhet kryesisht nga studentë të rinj, dhe nga nxënës të klasave të larta të shkollës së mesme, puntor të rregullt janë 12 persona (7 femra dhe 5 mashkuj), dhe bashkëpunorët tjerë.

Të gjitha punë janë kryer në mënyrë vullnetare, dhe të gjithë që kanë punuar janë anëtar të Organizatës JoQeveritare "Syri i Vizionit".


Organi më i lartë i organizatës është Kuvendi i Anëtarve, të cilin e përbëjnë të gjithë anëtarët e organizatës. Kuvendi i Anëtarve zgjedhë Shefin e Egzekutiv, Zhvilluesin e projekteve dhe Administratorin, të cilët merrin në realizim funksionimin e Organizatës dhe kryerjen e punëve rreth projekteve që përcaktohen nga Kuvendi i Anëtarve.

Udhëheqësit e organizatës dhe në të njëjtën kohë udhëheqës të aktiviteteve të ndryshme:

Veton MUJAJ – Shefi Egzekutiv (Kryetari i Organizatës)

Luan IBRAJ – Zhvillimin e Projekteve & Kordimin e Puneve me Media

Qenan BARDHAJ – Administrator & Financat



B) Projektet e rëndësishme në të kaluarën

Projekti më me rëndësi për organizatën tonë ka qenë dhe mbetet publikimi i revistës mujore për të rinj "Vizioni" (12 numra të botuar deri më tani). Donatorët kryesor: USAID-KTI i cili ka financuar 12 numra deri në Shtator 2001.

Artikujt me të cilët kryesisht mirret revista jonë kanë për qëllim vetëdijesimin e



rinisë në art, kulturë, sport, shoqëri të hapur, narkomani, ambient, prostitucion, turizëm, arsimim, teknologji, modë, çështje sociale dhe gjëra tjera të mira e të këqija që rinia e shoqërisë sonë përballet sot.

Struktura e revistës ka këtë përbërje: Kulturë 20%, Art dhe Muzikë 20%, Argëtim dhe rekreacion 20%, Sport 10%, Probleme rinore dhe sociale 15%, tjera 15%.

Numri i targetuar i lexuesve është rreth moshave 14 deri 28 vjeqare, dhe ata shtrihen në mbarë Kosovën.

Tre numrat e parë të revistës kanë të filluar të shpërndahën vetëm në Komunën e Pejës, për të vazhduar me numrin e katërt në gjithë Rajonin e Rrafshit të Dukagjinit. Me fillimin e realizimit të projektit të tretë, projekt ky 6 mujor me KTI/USAID, në këtë rast numrin e 6-të të revistës, bëhet shpërndarja në gjithë territorin e Kosovës.

Shpërndarja bëhet përmes "Rilindja" e cila merrë 25% nga shitja e revistës, dhe bënë shpërndarjen në 80% të kiosqeve në tërë Kosovën.

Sipas një sondazhi të bërë nga organizata "Galop International", revista jonë, për nga përqindja e popullatës më së shumti lexohët në Pejë, pastaj Prishtinë, Gjakovë, Kastriot, etj. Numri i shitjes ka arritur deri në 60% të botimit dhe është revista më e pëlqyer nga të rinjtë.

Si projekte tjera të organizatës kanë qenë edhe:

Organizimi i ngjarjeve të ndryshme me rastin e Javës Rinore që u mbajt në Shtator 2001, ku aktivitetet e organizatës sonë u koncentruan në Shkollën Speciale për të Verbër në Pejë, i cili organizim u ndihmua nga Kuvendi Komunal i Pejës. Gjatë kësaj ceremonie u paraqitë një program i pasur artistik, i përgaditur nga nxënësit e kësaj shkolle. Dhe në fund u organizua një koktel për të gjithë të ftuarit dhe pjesëmarrësit.



Organizimi i kremtimit të përvjetorit të punës së suksesshme të organizatës në Shtator 2001. Qytetarët lokal dhe firmat e tyre ndihmuan mbajtjen e këtij përvjetori. Në këtë përvjetorë i cili u mbajtë me date 29 Shtator 2001, në "Kampin Karagaç" në Pejë. Të pranishëm në këtë mbrëmje ishin të gjithë ata që për një vitë të tërë ndihmuan në punën e revistës dhe të Organizatës tone e në masë të madhe ishin: Organet qeverisëse të Komunës së Pejës (UNMIK, OSCE, Kuvendi Komunal, KFOR, TMK, etj), artistë nga e gjithë Kosova (këngëtar, piktorë, modelistë, etj), sportistë, talentë të rinj të fushave të ndryshme të jetës shoqërore dhe kulturore, donatorët, etj.

Gjatë kësaj mbrëmje pati shfaqje artistike nga këngëtarët, pastaj disa sfilata mode të përgaditura nga modelistët e Organizatës tonë, një ekspozitë me rreth 60 piktura nga të rinjtë e qytetit të Pejës një pjesë nga këta studentë të Akademisë së Arteve. E veçantë e kësaj mbrëmje ishin shpërblimet e dhëna për vendet e para në arritje një vjeçare për: Talent i ri, sportisti i vitit, qifti më i bukur i qytetit, "Fytyra e Vizionit".

Pjesmarrës ishin afërsisht 1000 vetë (me ftesa të veçanta) dhe mbrëmja zgjati prej orë 17:00 deri në 24:00.



C) FINANCAT

Të gjitha hyrjet gjatë kësaj periode ishin donacione të dhuruara nga USAID, si dhe të hyrat nga shitja e Revistes për të rinj "Vizioni". Fondet e pranuar dhe të shpenzuara janë si në tabelen e më poshtme.

Prespektivat për vitin 2002

- Si prespektiv kryesore e OJQ "Syri i Vizionit" gjetja e zgjidhjes se si të hyrat vetanake të jenë shumë ma të larta se sa donacionet e pranuara.
- Përqendrimi në vazhdimin e revistës për të rinj "Vizioni"
- Hapja e një biblioteke e cila do t'ju mundësoi të rinjve që të marrin libra të ndryshem me një çmim simbolik, por me qëllim që libri të filloj të lexohet më shumë tek të rinjtë tanë.
- Antarsimi dhe pagesa simbolike si antarë për OJQ "SiV"
- Hapja e një CD Clubi, që do të lehtësonte punën e të rinjve në punë me kompjuterë, përmes programeve të ndryshme kompjuterike dhe argëtimin e tyre sa më pak të kushtueshëm nëpërmes filmave dhe lojrave të ndryshme kompjuterike.
- Mbajtja e kongresit mbrenda organizates, e cila planifikohet të mbahet në fund të vitit 2002.
- Qëllimet e Organizates prap mbesin, vetëdijesimi i të rinjve për nevojën e involvimit të tyre në institucionet publike dhe në jetën shoqërore në përgjithësi, si dhe informimi i drejtë në aktivitete të ndryshme, ngjarje me rëndësi, demokraci, të drejta të njeriut, barazi gjinore, iniciativa të "liderëve të ardhshëm", përgjegjësitë e rinisë për ardhmërinë, arsimim, kulturë, art, sport, muzikë, ambient etj.